

STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"GREEN BUSINESS SOLUTION" Sh.p.k

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 104.2008 "Per Tregtaret the Shoqerite Tregtare".
- "Statuti" eshte Statuti i shoqërisë
- "Dite të Plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk e perfshin ditën kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditën për të cilën eshte dhene ose hyn në fuqi njoftimi.
-

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SE INTERNETIT

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi

- 1) Sot, me 12/07/2022, ne themeluesit, kemi hartuar statutin e ri te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin " GREEN BUSINESS SOLUTION" sh.p.k, te themeluar me 12/07/2022.
- 2) Themeluesi i shoqerise eshte:
 - Shoqeria "GREEN BUSINESS SOLUTION" sh.p.k., shoqeri e se drejtes shqipëtare, perfaqesuar nga administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, Znj. Besmira Rrika, shtetase shqipëtare, lindur në Zheje, Krujë, më 22/10/1992, banues në Shqipëri, madhore, me zotesi te plote për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. 030259044 dhe nr. personal J26022085W.

Neni 2
Objekti

Shoqeria kryen aktivitetin e meposhtem:

- Furnizimi, në çdo formë, i mallrave dhe shërbimeve për menaxhimin dhe zhvillimin e bizneseve.

Neni 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë do te jete a pacaktuar.

Neni 4

Selia, Adresa e Faqes së internetit dhe Adresa Elektronike

- 1) Selia e shoqërisë ndodhet në: **Rruga "Sami Frasheri", Pallati Alcion Kati 8, Apartamenti 12, Tiranë, Shqiperi.**

KREU II
KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 5



Vlera dhe Pagesa e Kapitalit të Regjistruar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000 (njqindmije) lek.
- 2) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuote me vlerë 100 %.

Neni 6

Kontributet

- 1) Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si mëposhtë:
 - Shoqëria "GREEN BUSINESS SOLUTION" shpk, sh.p.k., shoqëri e se drejtes shqipëtare, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me lekë 100.000 (njqind e njezetmije).
- 2) Sipas, kontributeve të mësipërme:
 - Shoqërisë "GREEN BUSINESS SOLUTION" shpk, i përkasin 100 % e kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7

Rritja dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shpërndarje, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- 2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblese së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 8

Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 1) Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas nenit 73 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 2) Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblyerje ashtu edhe pa shpërblyerje, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.
- 3) Në një rast të tillë ortakët që do të transferojnë pjesët e tyre të kapitalit duhet t'i njoftojnë ortakët e tjerë, me leter rekomandimi, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.
- 4) Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pësembedhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomandimi, për t'i komunikuar ortakët që transferojnë pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afat të caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 5) Në rast se oferta pranohet nga disa ortakët, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortakët që transferojnë pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me pjesët që ata zoterojnë, përveç rasteve kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 6) Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të treteve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblese që përfaqëson të paktën 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.
- 7) Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak të trashëgimitë mortis causa ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pelqimin e tyre për ortakët e rinj. Nëse ortakët e Shoqërisë nuk japin pelqimin e tyre për ortakët e rinj pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të treteve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin e Asamblese që përfaqëson të paktën 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.

KREU III

ASAMBLEJA DHE ADMINISTRATORËT

Neni 9

Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj



- 1) Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.
- 2) Vendimet e Asamblese se Zakonshme, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese jane te pranishem ne mbledhje ortaket qe perfaqesojne te pakten 25% (njëzetë e pesë përqind) te te gjithë kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese se zakonshme, per te cilat kerkohet nje shumice e kualifikuar, jane te vlefshme nese jane te pranishem ne mbledhje ortaket qe perfaqesojne te pakten 50% (pesedhjetë përqind) te te gjithë kapitalit themeltar.
- 3) Nese Asambleja nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne pikën 2, të nenit 11, te ketij statuti, Asembleja do te mbidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.
- 4) Asambleja e zakonshme vendos me shumice te kualifikuar prej 3/4 te votave te ortakeve te pranishem ne lidhje me ndryshimin e statudit, rritjen dhe zvogelimin e kapitalit, shperndarjen e fitimit, riorganizimin dhe zgjidhjen e shoqerise. Ne te gjitha rastet e tjera, pervec sa eshte parashikuar ne Ligj dhe ne statut, Asemblea vendos ne mbledhjen e zakonshme me voten e shumices se ortakeve te pranishem.

Neni 10

E drejta e pjesemarrjes dhe e votes

- 1) çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i pjeseve te kapitalit qe ai zoteron.
- 2) çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se cilës mund te jape voten e tij.
- 3) Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur.

Neni 11

Thirrja e Asamblese se Përgjithshme

- 1) Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel si dhe inventarit.
- 2) Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga nje prej Administratoreve ose nga nje ose disa prej ortakeve qe perfaqesojne me shume se 5% (pese përqind) te kapitalit themeltar.
- 3) Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande qe duhet t'u dergohet ortakeve - ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve - dhe ekspertit kontabel (nese eshte emeruar), te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, mbi çështjet qe do te trajtohen dhe per të cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.
- 4) Asambleja mund te thirret edhe jashte selise se Shoqerise.
- 5) Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'u lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te argumenteve; pasi të jene verifikuar keto kërkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari me të cilin duhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 6) Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.
- 7) Asambleja vendos mbi ndryshimet ne Statut me voten pro te ortakeve që perfaqesojne te pakten 3/4 (tre te katertat) e kapitalit themeltar.
- 8) çdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga e njejta Asamble. Per pasqyrimin e vendimit Asambleja emerone nje Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.
- 9) Vendimet e Asamblese duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.



Neni 12
Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet Znj. Besmira Rrika, shtetase shqiptare, lindur në Zheje, Krujë , më 22/10/1992, banuese në Shqipëri, madhore, me zotësi të plote për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID nr. 030259044 dhe nr. personal J26022085W, e cili emërohet për një afat 3 (tre) vjeçar.

- 1) Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator dhe maksimumi 3 (tre) Administratore, të cilët qëndrojnë në detyrëderi në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë maksimale prej 3 (tre) vjetësh.
- 2) Perfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratoreve, bashkarisht apo veçmas.
- 3) Administratoret mund të emërojnë perfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimësh.
- 4) Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit.
- 5) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve

KREU IV
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 13
Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 1) Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit;
- 2) Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit;
- 3) Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar (nese është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 4) Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 14
Fitimet

- 1) Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pese përqind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë përqind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që Asambleja vendos t'i vëre menjëherë, u shpërndahen ortakeve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 2) Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KREU V
SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 15
Prishja

- 1) Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakeve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut;
- 2) Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakeve.

Neni 16



Likuidimi

- 1) Ne rast prishje, Shoqeria duhet te likuidohet.
- 2) Per te administruar kete procedure, Asambleja emerone nje ose me shume likuidatore, të cilët paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme per te perfunduar likuidimin.
- 3) Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
- 4) Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcione me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 1) Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashte Shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.
- 2) Ne rast se nuk arrihet nje marreveshje atehere palet do ti drejtohen Gjykates.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE **Shoqeria "GREEN BUSINESS SOLUTION" shpk**

Perfaqesuar nga: Besmira Rrika

Besmira Rrika

Rrika